

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE TIRANE

Nr. 9908 Rep.

Nr. 864 Kol.  
2



## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane sot me date 21/09/2006, u paraqiten perpara meje noterit Majlinda Demollari, palet kontraktuese si me poshte vijon:

- Z. Irfan Hysenbelliu, i biri i Hasanit, datelindja 08/04/1959, lindur ne Skrapar, e banues ne Tirane, me nr. pasaporte Z 1472521, ortak i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Hysenbelliu" shpk, me seli ne Tirane, regjistruar ne Gjykatën e Tiranës me vendim nr. 19596, date 11.06.1998;

Me poshte i quajtur "Shitesi":

- Z. Luan Bregasi, i biri i Hysniut, datelindja 19/02/1956, lindur ne Mallakaster, e banues ne Tirane, me nr. pasaporte Z 1669028;

Me poshte i quajtur "Bleresi":

Pasi verifikova statusin juridik te paleve, une Noteri konstatova se palet e mesiperme jane me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ata kerkuan dhe rane dakord me redaktimin e kesaj Kontrate, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, sipas kushteve te meposhteme :

### *Kushtet paraprake*

- Shitesi, Irfan Hysenbelliu eshte ortak i vetem i shoqerise "Hysenbelliu" shpk.
- Bleresi ka qellim te bleje dhe Shitesi ka qellim te shese 100 % (njqint perqint) te kuotave te Shoqerise "Hysenbelliu" shpk.



- Bleresi ka analizuar, verifikuar dhe aprovuar situaten e pronesisë, atë financiare, dhe atë kontabile të Shoqërisë në momentin e firmosjes së kësaj kontrate.

*Meqenëse ekzistojnë kushtet paraprake të mesipërme, palet bien dakort si më poshtë vijon:*

### **Neni 1 - Kushtet paraprake**

Kushtet paraprake të mesipërme janë pjesë përberëse e kësaj Kontrate.

### **Neni 2 - Blerja e kuotave**

- 2.1. Shitesi merr përsipër të shesë dhe të transferojë tek Bleresi dhe Bleresi merr përsipër të blejë 100 % (njëqint për qint) të kuotave të Shoqërisë që zotërohen nga Shitesi, tërësisht të lira nga çdo kufizim në favor të të tjerëve, me cmimin 2 488 456 (dy mijone e katërqintë tetëdhjetë e tetë mijë e katërqintë e pesëdhjetë e gjashtë) euro.
- 2.2. Paguesa e cmimit të përcaktuar më sipër do të bëhet nga Bleresi, në castin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

### **Neni 3 - Detyrimet dhe Garancite**

Më nënshkrimin e kësaj kontrate dhe në çdo moment pas lidhjes së saj, Shitesi do t'i dorëzojë Bleresi, pranë selisë së Shoqërisë, librat origjinale kontabel të Shoqërisë, si dhe çdo dokument tjetër, pasuri ose të mira të tjera materiale aktualisht në pronësi të Shoqërisë, ose që në të ardhmen do të vijne në favor të Shoqërisë.

### **Neni 4 - Korrespondenca**

Të gjitha njoftimet, kërkesat si dhe komunikimet e tjera ndërmjet palëve do të realizohen me shkrim dhe do të dërgohen në selinë e Shoqërisë.

### **Neni 5 - Shpenzimet dhe taksat**

Shpenzimet ligjore, si dhe çdo lloj tjetër shpenzimi lidhur me këtë kontratë, janë në ngarkim të palës që i ka kryer. Në çdo rast taksat, si dhe shpenzimet e noterisë lidhur me këtë kontratë janë në ngarkim të Bleresit.

### **Neni 6 - Trashegimi dhe transferimi**

6.1. Kjo Kontrate perben detyrim per palet dhe do te kete efekt midis tyre, si edhe tek trashegimtaret dhe personat qe kane ndonje te drejte ndaj tyre si dhe ne te ardhmen.

6.2. Ne cdo rast, asnjera nga palet nuk mund te heqe dore nga kjo kontrate, pa marre me pare miratimin me shkrim te pales tjeter.

### Neni 7 - Permbajtja e kontrates dhe ndryshimet

Kjo kontrate perfshin teresisht marredheniet midis paleve dhe zevendeson te gjitha marreveshjet e mepareshme me kete objekt. Modifikimet ose shmangiet e mundshme nga kjo kontrate, mund te behen vetem me shkrim dhe te konfirmohen nga palet e me pas t'i bashkengjiten kesaj kontrate.

### Neni 8 - Forca Madhore

8.1. Ne kuptimin e kesaj kontrate, me force madhore do te kuptohet, pa asnje kufizim, cdo mase e Autoriteteve Publike, qe mund te kete ose jo forcen e ligjit, cdo sanksion i organeve kombetare ose nderkombetare, cdo ngjarje e jashtezakonshme dhe e paparashikuar, ose cdo lloj shkakut tjeter i pavarur nga faji ose neglizhenca e te dyja paleve, ose dhe cdo ngjarje e ngjashme ose me te mesipermet, mjafton qe te jete jashte mundesive te arsyeshme te kontrollit te paleve.

8.2. Mospermbushja ose vonesa ne permbushjen e detyrimeve qe rrjedhin nga kontrata prej paleve ose te njeres prej tyre, nuk do te konsiderohet pergjegjesi e paleve ose e c'donjeres prej tyre, perderisa mund te perfshihet ne rastet e parashikuara si force madhore. Periudha per te cilen eshte shtyre ose vonuar permbushja, ashtu si edhe periudha e nevojshme per riparimin e demeve te shkaktuara gjate voneses, do te mblidhen se bashku per te vendosur afatin e parashikuar nga kjo kontrate, per permbushjen e ketyre detyrimeve.

8.3. Pala qe deklaroi ndodhjen e ngjarjes se forces madhore duhet t'ia komunikojte kete pales tjeter, sic parashikohet ne nenin 4, sa me shpejt te jete e mundur pasi ka verifikuar ngjarjen.

### Neni 9 - Origjinalet

Kjo kontrate eshte hartuar ne 5 (pese) kopje origjinale, ne gjuhen shqipe, te gjitha te nenshkruara nga palet ne date 11.09 2006.

### Neni 10 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Te gjitha mosmarreveshjet midis paleve qe rrjedhin, ose ne cdo menyre lidhen me interpretimin dhe/ose ezekutimin e kesaj kontrate, te cilat nuk arrihet te

zgjidhen me mirekuptim midis paleve, do t'i parashtrohen per shqyrtim perfundimtar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

### Neni 11 - E drejta e zbatueshme

Kjo kontrate, si dhe te drejtat dhe detyrimet e paleve ne te do te rregullohen nga legjislacioni shqiptar.

### Neni 12 - Vlefshmeria

Kjo kontrate hyn ne fuqi me nenshkrimin e saj nga palet dhe garantuesi, dhe zevendeson cdo marreveshje tjeter te mepareshme me objekt te ngjashem, e cila konsiderohet e revokuar.

*Une, Noteri pasi ua lexova me ze te larte paleve kete Kontrate, dhe u sigurova per identitetin e tyre, konstatova se ata e gjejne ate te rregullt ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe Une i vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit.*

Bleresi:

*Z. Luan Bregasi*


Z. Luan Bregasi

*Z. Luan Bregasi*

Shitesi:

*Z. Irfan Hysenbelliu*

Z. Irfan Hysenbelliu



NOTER

NOTERE

*Majlinda E. Demollari*

TEL + 355 4 / 269948

*Majlinda E. Demollari*